



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA-THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË



RREGULLORE PËR NDARJEN E BURSIVE
PËR NXËNËS/E DHE
STUDENTË/E TË KOMUNËS SË SUHAREKËS

SUHAREKË

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c) të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2019, miratoi këtë;

RREGULLORE PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË/E DHE NXËNËS/E TË KOMUNËS SË SUHAREKËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet dhe kriteret për ndarjen e bursave për student/e dhe nxënës/e të cilët vazhdojnë mësimet në shkollën e mesme të lartë dhe studiojnë në Universitetet publike të Republikës së Kosovës, për studentët dhe nxënësit e komunës së Suharekës.

Neni 2

Të gjithë studentët/et e rregullt dhe nxënësit e shkollave të mesme të larta, banorë të Komunës së Suharekës, pa dallime etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në ndonjë shkollë të mesme të lartë apo fakultete të Universiteteve publike, kanë të drejtë të konkurrojnë për marrjen e bursave për studime në Kosovë, në përjashtim të kolegjeve private, studimeve master dhe post-diplomike.

Neni 3

Kryetari i Komunës merr vendim për numrin e bursave që do të ndahen për shkolla të mesme dhe fakultete si dhe shumën financiare për një bursë e cila ndahet për një vit akademik-shkollor.

Neni 4.

4.1 Bursat për student/e dhe nxënës/e të shkollës së mesme të lartë, do të ndahen nga Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës.

4.2 Komisioni do të jetë i përbërë prej 5 anëtarëve dhe do të kenë këtë përbërje;

4.2.1 3 (tre) anëtar do të emërohen nga Kuvendi i Komunës, ndërsa

4.2.2 2 (dy) anëtar do të emërohen nga Kryetari i Komunës

Neni 5

5.1 Drejtoria e Arsimit do të shpallë konkursin për ndarjen e bursave. Konkursi duhet të jetë i shpallur në mjetet e informimit publik, përkatësisht në një gazetë ditore, në faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve.

5.2 Konkursi do të zgjasë 15 ditë, nga dita e publikimit.

5.3 Në konkurs do të përcaktohet dokumentacioni i kërkuar dhe informatat tjera të nevojshme.

Neni 6

Obligohet; Drejtoria e Arsimit, që të kryejë punët tekniko-administrative të domosdoshme që rrjedhin nga natyra e punës së Komisionit siç janë: shpallja e konkursit, pranimi i kërkesave, formulimi i kontratave e të ngjashme.



KUSHTET DHE KRITERET

Neni 7

- 7.1 Për realizimin e të drejtës në bursë, kandidatët /et duhet t'i plotësojnë këto kushte:
- 7.2 Të kenë të regjistruar vitin shkollor/akademik për të cilin jepet bursa, (vërtetimi i regjistrimit të semestrit për vitin akademik të studimeve për të cilin jepet bursa, vlen edhe për studentët që janë dy e më shumë student të të njëjtës familje).
- 7.3 Të mos jenë shfrytëzues/e i ndonjë burse tjetër, e cila dëshmohet me vërtetim nga Fakulteti ku studion.
- 7.4 Për kandidatët/et që janë regjistruar për herë të parë në fakultet të kenë dëshminë e suksesit të vitit paraprak(Diploma dhe dëftesa e vitit të fundit të shkollës së mesme të lartë)
- 7.5 Gjendja ekonomike sociale e familjes, e cila dëshmohet me vërtetim nga Qendra për punë sociale.

VLERËSIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE

Neni 8

- 8.1. Fëmijët e dëshmorëve të cilët janë student dhe nxënës të shkollave të mesme të larta, do të ju ndahet bursa jashtë kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore, por të gjithë studentët dhe nxënësit e kësaj kategorie janë të obliguar ta sjellin vërtetimin e regjistrimit të semestrit për vitin akademik të studimeve kur ndahet bursa.
- 8.2 Kriteret dhe prioritetet për fitimin e së drejtës në bursë janë si më poshtë:
- 8.2.1 Nota mesatare 9 deri në 10.00, në fakultete, vlerësohet me 20 pikë,
- 8.2.2 Nota mesatare 8 deri në 8.99 në fakultete, vlerësohet me 15 pikë,
- 8.2.3 Nota mesatare 7 deri në 7.99, në fakultete, vlerësohet me 10 pikë,
- 8.2.4 Nota mesatare 6 deri në 6.99 në fakultet vlerësohet me 5 pikë.
- 8.2.5 Suksesi i shkëlqyeshëm 4.5 deri në 5 në shkollat e mesme të larta vlerësohet me 20 pikë,
- 8.2.6 Suksesi shumë mirë: 3.5 deri në 4.49 në shkollat e mesme vlerësohet me 15 pikë,
- 8.2.7 Suksesi i mirë: 2.5 deri në 3.49 në shkollën e mesme vlerësohet me 10 pikë,
- 8.2.8 Për familjet që kanë 2 (dy) student nga e njëjta familje 10 pikë,
- 8.2.9 Për familjet që kanë tre student(vëllezër - motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë të tjera.
- 8.2.10 Për kandidatët e SHML që kanë dy nxënës nga e njëjta familje vlerësohen me 10 pikë.
- 8.2.11 Për familjet që kanë tre (3) nxënës në shkollat e mesme të larta (SHML), (vëllezër -motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë.
- 8.2.12 Pikët e studentëve janë të vlefshme vetëm për kategorinë e studentëve dhe pikët e nxënësve llogariten vetëm për kategorinë e nxënësve të të njëjtës familje.
- 8.2.11 Gjendja ekonomike- financiare(rastet sociale) vlerësohen me 30 pikë.
- 8.2.12 Studentët/ nxënësit të cilët nuk kanë asnjërin prind në jetë, fitojnë bursën me automatizëm,
- 8.2.13 Fëmijët pa njërin prind vlerësohen me 10 pikë,
- 8.2.14 Fëmijët që i kanë të dy prindërit me aftësi dhe që është vetë me aftësi të kufizuar vlerësohen me 15 pikë.
- 8.2.15 Fëmijët e ish të burgosurve politikë dhe ish të dënuarve politikë, vlerësohen me 8 pikë,
- 8.2.16 Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së, vlerësohen me 12 pikë,
- 8.2.17 Fëmijët të cilët nuk kanë asnjërin prind të punësuar dhe nuk krijojnë te ardhura nga asnjë veprimtari, vlerësohen me 15 pikë. Kjo dëshmohet me vërtetimin e lëshuar nga Enti për punësim.
- 8.2.18 Komisioni ruan të drejtën të hulumtojë dhe vërtetojë gjendjen e vërtetë ekonomike-financiar të kandidatit.

- 8.2.19 Fëmijët e viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë vlerësohen me 12 pikë,
8.2.20 Fëmijët e veteranëve të luftës të UÇK-së vlerësohen me 8 pikë.
8.2.21 Nga e njëjta familje mund të përfiton bursë vetëm një student/e dhe nxënës/e, pa marrë parasysh kategorinë e tyre.
8.2.22 Nxënësit/et, që kanë ponetim të barabartë pas shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë nxënësit/et që kanë distancë më të largët nga institucionet shkollore.

Neni 9

9.1 Përfitues të bursës nuk mund të jenë këto kategori:

- 9.1.1. Studentët/et dhe nxënësit/et, që kanë dy prind të punësuar në institucionet publike (shtetëror).
9.1.2. Studentët/et dhe nxënësit/et, që prindërit e tyre kanë biznes të regjistruar dhe aktiv, e cila dëshmohet me vërtetim nga Qendra e regjistrimit të biznesit.
9.1.3. Përfitues i kësaj burse nuk mund të jetë studenti/nxënësi, nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër për fushën e arsimit.
9.1.4. Nëse vërtetohet se studenti i cili është përfitues i bursës nga komuna, merr bursë edhe nga ndonjë njësi tjetër buxhetore, ai/a jo obligohet ta kthejë bursën.

Neni 10.

Kandidatët me numër të barabartë të pikëve, përparësi do tu jepet atyre me notë mesatare më të lartë gjatë shkollimit të tyre.

VLERËSIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE

Neni 11.

Pas skadimit të afatit të konkurrimit, Komisioni do të bëjë vlerësimin e kërkesave, Komisioni gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesave do të përcaktojë vetë metodologjinë e punës dhe mënyrën e seleksionimit të kërkesave, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 12.

12.1 Komisioni pas përfundimit të procedurës së seleksionimit do të hartojë listën përfundimtare të kandidatëve/ve përfitues/e të bursës.

12.2 Lista e përfituesve do të shpallet publikisht dhe do të vendoset në tabelën e shpalljeve pranë Drejtorisë së Arsimit.

Neni 13.

Kundër vendimit të komisionit për ndarjen e bursave, mund t'i bëhet ankesë Komisionit për shqyrtimin e ankesave i cili formohet nga Kuvendi i Komunës. Ankesa parashtrohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së listës së përfituesve të bursës nga ana e Komisionit.

Neni 14.

14.1 Me nxënësit/et përkatësisht studentët/et që fitojnë bursën, do të lidhet kontratë me shkrim të cilën e harton komisioni mbi ndarjen e bursave dhe nënshkruhet nga përfituesi i bursës dhe Kryetari i Komunës.

14.2 Me kontratë do të përcaktohet kohëzgjatja e shfrytëzimit të bursës, obligimet e përfituesit/es të bursës dhe kushtet tjera.

14.3 Nëse brenda afatit prej 45 ditëve, nga dita e njoftimit të kandidatit/es, përfitues/e të bursës, nuk nënshkruhet kontrata nga ana e studentit/es nxënësit/es, konsiderohet se ka hequr dorë nga shfrytëzimi i bursës.

PROCEDURAT E PAGESËS

Neni 15.

15.1 Mjetet do të barten në dy periudha të caktuara gjatë vitit në xhirollogaritë e studentit/es dhe nxënësit/es, në ndonjë bankë komerciale në të cilën studenti/ja dhe nxënësi/ja janë të obliguar ta hapin xhirollogarinë bankare.

15.2 Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe Drejtoria për arsim do të kujdeset për bartjen e mjeteve financiare në afatin e përcaktuar kohorë.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet, në procedurë të njëjtë me atë të miratimit duke e arsyetuar me shkrim nga propozuesi.

Neni 17

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe student/e të Komunës së Suharekës 01-Nr-16-540, e datës 29.10.2010 dhe Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe student/e të Komunës së Suharekës 01-Nr.16-7576 e datës 31.10.2014.

Neni 18

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, kjo Rregullore hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-616-7790
Më datë 31.01.2019



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI